



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

V E N D I M

Nr.70, datë 31.08.2005

**PËR MIRATIMIN E
"RAPORTIT TË POLITIKËS MONETARE
PËR MUAJIN KORRIK TË VITIT 2005"**

Në mbështetje të nenit 43, shkronja "ç" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", me propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

V E N D O S I:

1. Të miratojë "Raportin e Politikës Monetare për muajin korrik të vitit 2005", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

Ylli Memisha

KRYETARI

Ardian Fullani

BANKA E SHQIPËRISË

RAPORTI I POLITIKËS MONETARE PËR MUAJIN KORRIK 2005

GUSHT 2005

PËRMBAJTJA

Zhvillimet kryesore	4
I. Ecuria e inflacionit në muajin korrik	5
I.1 Ecuria e inflacionit dhe e grupeve përbërëse	6
I.2 Ambianti makroekonomik dhe çmimet e konsumit	8
II. Zhvillimet monetare dhe tregjet financiare	10
II.1 Politika monetare dhe objektivat sasiorë	10
II.2 Agregatët monetarë.....	11
II.3 Kërkesa e ekonomisë për para	14
II.3.1 Mjetet valutore neto.....	14
II.3.2 Krediti i brendshëm	15
II.3.3 Kërkesa e qeverisë për para	15
II.3.4 Kredia për ekonominë nga sistemi bankar.....	16
II.4 Tregjet dhe ecuria e normave të interesit	17
II.4.1 Ecuria e likuiditetit	17
II.4.2 Ecuria e normave të interesit	18
II.4.3 Kursi i këmbimit	20

ZHVILLIMET KRYESORE

- Norma vjetore e inflacionit në muajin korrik u ul në 1.8 për qind, nga 2.9 për qind në muajin qershor, duke qëndruar shumë afër kufirit të poshtëm të objektivit të Bankës së Shqipërisë. Norma mesatare vjetore shënoi 2.1 për qind, ndërsa inflacioni mujor ishte -1.2 për qind.
- Norma vjetore e inflacionit është përcaktuar në një masë të madhe nga inflacioni negativ i mallrave ushqimorë si edhe nga rritja, e mbartur që nga fillimi i vitit, e çmimit të energjisë elektrike. Politika fiskale dhe ajo monetare kanë krijuar një ambient të përshtatshëm për qëndrueshmërinë e çmimeve të konsumit. Gjithashtu, mbiçmimi vjetor i kursit të këmbimit ka zbutur presionet inflacioniste të shkaktuara nga rritja e çmimit të naftës.
- Zhvillimet makroekonomike kanë kushtëzuar ruajtjen e një qëndrimi neutral të politikës monetare nga Banka e Shqipërisë. Norma e inflacionit vjetor është luhatur në nivele relativisht të ulëta, ndërsa ecuria e treguesve kryesorë monetarë ka reflektuar tendencën me kah zbutjeje që ka patur politika monetare
- Rritja vjetore e ofertës monetare në muajin qershor u përshpejtua në 18.3 për qind, nga 15.8 për qind në muajin maj. Kontributin kryesor e ka dhënë rritja vjetore e depozitave në valutë. Gjithashtu, ritmi i rritjes së agregatit M2, ka qenë në rritje, duke reflektuar rritjen e kërkesës për para të qeverisë dhe të ekonomisë në muajin qershor.
- Në muajin qershor rritja vjetore e parasë jashtë bankave arriti në 14.9 për qind nga 11.6 për qind në muajin maj, kryesisht nën ndikimin e faktorëve të përkohshëm. Kjo rritje ka shtuar nevojat për likuiditet të sistemit bankar, të cilat janë përballuar nëpërmjet uljes së nivelit të likuiditeteve të tepërta të bankave. Si pasojë në muajin qershor është tejkaluar objektivi për mjetet e brendshme neto të Bankës së Shqipërisë.
- Kredia për ekonominë në muajin qershor arriti në 95.9 miliardë lekë, duke u rritur me 7.1 miliardë lekë brenda muajit. Gjatë muajit qershor është akorduar 12.7 miliardë lekë kredi e re. Ky nivel përbën nivelin më të lartë të kredisë së re të akorduar brenda një muaji.
- Në muajin qershor normat e interesit për depozitat dhe kreditë në lekë janë ulur. Ndërsa në muajin korrik, në tregun ndërbankar dhe në atë primar të letrave me vlerë të qeverisë, normat e interesit kanë shfaqur rritje të lehtë.
- Megjithëse nën presionin e efekteve sezonale, leku ka qenë i qëndrueshëm kundrejt valutave kryesore gjatë muajit korrik. Nivelet e këmbimit të lekut në fund të muajit korrik janë 121.3 lek/euro dhe 100.4 lek/usd, kundrejt niveleve përkatësisht 123.9 lek/euro dhe 102.8 lek/usd në fund të muajit qershor.

I. ECURIA E INFLACIONIT NË MUAJIN KORRIK

Muaji korrik, ashtu si dhe gjashtëmuajori i parë i vitit 2005 u karakterizua nga një normë e ulët inflacioni. Normat vjetore dhe mujore të inflacionit ishin përkatësisht 1.8 dhe -1.2 për qind. Inflacioni mesatar vjetor¹ ishte 2.1 për qind, duke qenë pothuajse në kufirin e poshtëm të intervalit objektiv prej 2 – 4 për qind.


Tabelë 1. Norma vjetore e inflacionit (në për qind).

	2001	2002	2003	2004	2005
Janar	2.2	6.5	0.0	3.3	3.3
Shkurt	1.5	7.6	1.1	4.4	1.8
Mars	2.9	7.5	1.3	4.0	1.6
Prill	3.0	6.5	2.3	3.2	1.3
Maj	2.5	4.6	2.8	2.6	2.0
Qershor	4.0	3.7	2.6	2.9	2.9
Korrik	5.6	4.2	3.0	3.1	1.8
Gusht	4.1	5.5	3.0	2.7	
Shtator	3.5	5.3	2.8	2.0	
Tetor	1.8	5.8	2.9	2.0	
Nëntor	2.8	3.7	3.4	2.2	
Dhjetor	3.5	1.7	3.3	2.2	
Mesatar	3.1	5.2	2.2	3.0	2.1

Burimi: INSTAT.

Zhvillimet e favorshme makroekonomike kanë krijuar kushte për mbajtjen nën kontroll të normës së inflacionit. Politika fiskale e kujdeshme ka frenuar presionet inflacioniste, ndërkohë që politika monetare ka synuar të akomodojë zhvillimet aktuale dhe të pritshme në inflacion pa rrezikuar objektivin për inflacionin. Mbiçmimi i vazhdueshëm i kursit të këmbimit si dhe rënia e ndjeshme e çmimeve të produkteve bujqësore, kanë vazhduar të shërbejnë si mburojë ndaj presioneve inflacioniste të injektuara në ekonomi nëpërmjet çmimeve të administruara dhe atyre të naftës në tregun ndërkombëtar.

Grafik 1. Inflacioni vjetor (në për qind).




¹ Inflacioni mesatar vjetor është vlera mesatare e inflacionit vjetor të 12 muajve të fundit përfshirë muajin që analizohet.

I.1 ECURIA E INFLACIONIT DHE E GRUPEVE PËRBËRËSE.

Inflacioni vjetor në muajin korrik ishte 1.3 pikë përqindjeje më i ulët, në krahasim me muajin korrik të vitit të kaluar (3.1%). Ashtu si gjatë dy viteve të fundit, edhe gjatë këtij muaji profili i inflacionit vjetor ka vazhduar të përcaktohet nga ecuria në çmimet e dy grupeve kryesore "Ushqime dhe pije joalkoolike" dhe "Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji". Kontributi i përbashkët i këtyre dy grupeve në normën vjetore të inflacionit, në muajin korrik ishte 1.3 pikë përqindjeje ndërkohë që grupet e tjera të shportës së konsumit kontribuan me 0.5 pikë përqindjeje.

Grafik 2. Kontributi i grupeve kryesore në inflacionin vjetor (në pikë përqindjeje).



Pas rritjes së përkohshme të shënuar në muajin qershor, inflacioni vjetor i grupit "Ushqime dhe pije joalkoolike" iu rikthye normave negative të regjistruara që nga fillimi i këtij viti. Në muajin korrik, grupi "Ushqime dhe pije joalkoolike" uli me -0.7 pikë përqindjeje normën totale të inflacionit vjetor. Niveli i çmimeve të këtij grupi është kushtëzuar nga ecuria e çmimeve të produkteve bujqësore². Nga ana tjetër, mbiçmimi i lekut ndaj euros kombinuar me rënien e çmimeve të mallrave ushqimorë në vendet partnere si Italia dhe Greqia, ka zbutur ose ka eliminuar krejtësisht presionet e jashtme inflacioniste.

Tabelë 2. Norma vjetore e inflacionit të grupit "Ushqime dhe pije joalkoolike" (në vend dhe jashtë) si dhe kontributi i inflacionit të këtij grupi në inflacionin total.

	Inflacioni vjetor'04	Kontributi (pp)	Inflacioni vjetor'05	Kontributi (pp)	Itali ³ Inflacioni vjetor'05	Greqi ⁴ Inflacioni vjetor'05
Janar	3.2	1.4	-0.7	-0.3	-0.7	0.6
Shkurt	2.7	1.2	-1.2	-0.5	-0.4	-0.9
Mars	2.3	1.0	-1.7	-0.7	-0.2	-1.4
Prill	0.1	0.1	-2.3	-1.0	-0.2	-0.1
Maj	-1.1	-0.5	-0.7	-0.3	-0.2	-0.4
Qershor	-0.7	-0.3	1.6	0.7	-0.2	-0.5
Korrik	-0.1	-0.05	-1.6	-0.7		

Ndërsa dinamika e normës së inflacionit përcaktohet nga ecuria e inflacionit të grupit "Ushqime dhe pije joalkoolike", amplituda e normës së inflacionit ndikohet nga inflacioni i

² Çmimet e frutave u ulën me 10.7për qind, kurse çmimet e perimeve me 2.9 për qind.


³ Burimi: ISTAT; faqja e internetit <http://www.istat.it>

⁴ Burimi: General Secretariat of National Statistical Service of Greece; faqja e internetit: <http://www.statistics.gr>

grupit "Qira, ujë, lëndë djegëse, energji". Në mungesë të kontributit të këtij grupi, inflacioni në vend do të ishte më i ulët (grafiku 3).

Në muajin korrik, inflacioni vjetor i grupit "Qera, ujë, lëndë djegëse, energji" shënoi një rritje prej 7.7 për qind dhe kontribuoi me 2.0 pikë përqindjeje në normën vjetore të inflacionit. Ndërsa, çmimi i administruar i energjisë ka mbetur i pandryshuar që nga muaji shkurt, çmimet e qirasë dhe të rentës së imputuar janë luhatur ndjeshëm. Kështu, inflacioni mesatar i nëngrupeve "Qira" dhe "Renta e imputuar" është ulur nga 5.7 për qind në tremujorin e parë, në 2.3 për qind në tremujorin e dytë, për t'u rritur përsëri në 3.3 për qind në muajin korrik. Rritja e çmimit të qirasë në këtë muaj vjen si pasojë e rritjes së kërkesës në vend, për shkak të fillimit të sezonit turistik.

Grafik 3. Ecuria e inflacionit vjetor total dhe ecuria e inflacionit pa grupin "Qira, ujë, lëndë djegëse, energji".



Krahas çmimit të energjisë elektrike⁵, çmime të tjera të administruara si tarifata shëndetësore dhe arsimore kanë ushtruar presione inflacioniste, duke rritur kostot e konsumatorit. Gjatë periudhës janar – korrik'05, grupet "Shëndeti" dhe "Shërbimi arsimor" kanë shënuar norma të larta inflacioni, por si rrjedhojë e peshës së vogël⁶ që ato kanë në shportën e konsumit, kontributi i tyre mesatar në inflacionin e kësaj periudhe ka qenë marzhinal.


Rritja e çmimit të naftës në tregun ndërkombëtar është reflektuar në një rritje të lehtë të inflacionit të grupit "Transport". Pas muajve maj – qershor'05, gjatë të cilëve inflacioni i grupit "Transport" ka mbetur i pandryshuar në nivelin 3.0 për qind, muaji korrik shënoi rritje të inflacionit të këtij grupi në 3.8 për qind. Kjo rritje ka ardhur kryesisht nga rritja e inflacionit të nëngrupit "Shërbime ndaj mjeteve personale"⁷, në të cilin jep ndikimin e tij edhe çmimi i naftës së përdorur nga konsumatori shqiptar.

⁵ I cili u rrit me 25.7 për qind, në muajin janar 2005.

⁶ Përkatësisht grupet zënë një peshë prej 2.1 dhe 1.0 për qind në shportën e konsumit.

⁷ Inflacioni vjetor i këtij nëngrupi për muajt qershor dhe korrik'05 është përkatësisht 6.2 dhe 8.8 për qind.

Grafik 4. Inflacioni vjetor i 4 grupeve kryesore të shportës së IÇK-së (në për qind).



Inflacioni i grupeve të tjera të shportës është luhatur në përputhje me tendencat e tyre sezonale. Inflacioni i grupit “Veshje dhe këpucë” është ulur në -2.6 për qind, ndërsa inflacioni i grupit “Pije alkoolike dhe duhan” është rritur në 2.9 për qind. Rritje më të ndjeshme ka shënuar inflacioni i grupit “Hotele, kafene, restorante” me inflacion vjetor 2.4 për qind, duke reflektuar rritjen e kërkesës për këto shërbime, si pasojë e sezonit turistik.


1.2 AMBIENTI MAKROEKONOMIK DHE ÇMIMET E KONSUMIT

Gjatë vitit 2005 inflacioni vjetor është rritur me ritme të ngadalta, duke bërë të mundur ruajtjen e ekuilibrave makroekonomikë. Prej mëse dy vjetësh, normat e ulëta pozitive të inflacionit janë rezultat i koordinimit të mirë të politikave ekonomike dhe i mungesës së goditjeve nga ana e faktorëve të kërkesës dhe ofertës. Presionet inflacioniste të injektuara nga ana e kostove si rritja e çmimeve të administruara, rritja e çmimeve të prodhimit, rritja e çmimit të naftës dhe rritja e pagave janë balancuar pothuajse plotësisht nga mbiçmimi i kursit të këmbimit, nga oferta bujqësore si dhe nga mungesa e presioneve të jashtme.

- Politika monetare

Lehtësimi i politikës monetare nga ana e Bankës së Shqipërisë nuk ka nxitur presionet inflacioniste. Ulja e normës bazë të interesit, nëpërmjet nxitjes së kredithënies ka çuar në rritjen e ofertës së parasë. Megjithatë, normat e ulëta të inflacionit kanë siguruar norma pozitive të interesit real, duke kanalizuar fondet e lira të ekonomisë në sistemin bankar.


Grafik 5. Ndryshimi vjetor i parasë jashtë bankave ndaj M3 (grafiku majtas) dhe ndryshimi vjetor i ofertës së parasë M3 (grafiku djathtas).



- **Politika fiskale**

Zbatimi i kujdesshëm i politikës fiskale si dhe realizimi i shpenzimeve në përputhje me programin buxhetor, kanë krijuar kushte për kontrollimin e normës së inflacionit. Gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2005, shpenzimet buxhetore korente dhe kapitale janë rritur me ritme të përshpejtuara. Megjithatë, deri në muajin qershor shpenzimet totale kanë qenë brenda masës së programuar, duke mos ushtruar presione inflacioniste në ekonomi.

Grafik 6. Norma vjetore e inflacionit (boshti majtas) dhe rritja vjetore e shpenzimeve buxhetore (boshti djathtas).



- **Kursi i këmbimit dhe inflacioni i importuar**

Kursi i këmbimit të lekut kundrejt euros dhe dollarit edhe në muajin korrik, ka qenë faktori kryesor që ka kontrolluar presionet inflacioniste të ambientit të jashtëm. Në muajin korrik, leku në terma vjetorë është mbiçmuar me rreth 1.8 për qind ndaj euros, ndërsa ndaj dollarit ka mbetur pothuajse i pandryshuar. Prej shumë kohësh, ky faktor ka shërbyer si pengesë për importimin e inflacionit të vendeve partnere tregtare.

Tabelë 3. Ndryshimet vjetore në inflacionin e vendeve partnere dhe në kursin e këmbimit (në përqindje).

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik
Greqi ⁸	4.0	3.1	2.9	3.4	3.2	3.3	3.9
Itali ⁹	1.9	1.9	1.9	1.9	1.9	1.8	
Lek/Euro	-5.3	-4.8	-3.1	-1.6	-2.3	-1.0	-1.8
Lek/Usd	-8.8	-7.4	-9.8	-8.9	-7.4	-1.2	0.0

- **Prodhimi bujqësor.**


Oferta e prodhimit bujqësor ka ndikuar në uljen e normës së inflacionit në vend. Prodhimet bujqësore të fushës si dhe prodhimi i serrave, kanë arritur të plotësojnë kërkesën e brendshme. Çmimet më të ulëta të fruta – perimeve kanë sjellë uljen e normave vjetore të inflacionit të grupit "Ushqime dhe pije joalkolike" të shportës së konsumit. Falë peshës së konsiderueshme të këtij grupi në shportën e konsumit, norma vjetore e inflacionit është ndikuar ndjeshëm nga ecuria e çmimeve të këtyre prodhimeve.

⁸ Burimi: General Secretariat of National Statistical Service of Greece; faqja e internetit:

<http://www.statistics.gr>

⁹ Burimi: ISTAT; faqja e internetit <http://www.istat.it>

Grafik 7. Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të fruta-perimeve¹⁰ (%)



- **Çmimet e naftës.**


Një rrezik të mundshëm për rritjen e inflacionit në vendet importuese të naftës (ku bën pjesë dhe vendi ynë) mbetet ecuria e çmimit të naftës. Ndikimi i drejtpërdrejtë në çmimet e konsumit është shfaqur në formën e rritjes së inflacionit të grupit "Transport". Kjo rritje ka pasur dhe pritet të ketë një efekt modest në nivelin e përgjithshëm të çmimeve. Një efekt më i ndjeshëm por jo direkt i diktueshëm në çmimet e konsumit, mund të jetë rritja e kostos së prodhimit. Zhvillimet e fundit, veçanërisht kuotimi i naftës përtej nivelit 70 dollarë për fuçi, kanë rritur rreziqet si për inflacionin ashtu dhe për rritjen ekonomike.

II. ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET FINANCIARE

II.1 POLITIKA MONETARE DHE OBJEKTIVAT SASIORË

Zhvillimet makroekonomike kanë kushtëzuar ruajtjen të pandryshuar të qëndrimit të politikës monetare nga Banka e Shqipërisë gjatë muajve qershor dhe korrik. Presionet inflacioniste në ekonomi kanë reflektuar zhvillimet sezonale në ecurinë e prodhimit vendas. Ecuria e normës së inflacionit është ndikuar ndjeshëm nga ulja e çmimeve të prodhimeve bujqësore, si rezultat i shtimit të ofertës së prodhimeve vendase, gjatë periudhës së verës. Norma e inflacionit është luhatur në nivele relativisht të ulëta, ndërsa ecuria e treguesve kryesorë monetarë ka reflektuar tendencën me kah zbutjeje që ka patur politika monetare.

Grafik 8. Rritja vjetore e M3 real.



¹⁰ Ndërtuar me të dhënat javore të marra nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit.

Përdorimi i instrumenteve mbështetëse nga Banka e Shqipërisë ka mundësuar plotësimin e nevojave dhe thithjen e tepërcave afatshkurtra të sistemit bankar për likuiditet, duke synuar njëkohësisht zbutjen e luhatshmërisë së normave të interesit në treg. Në muajin qershor norma e ponderuar e interesit të fluksit të depozitave të reja në lekë, shënoi 3.5 për qind duke regjistruar një ulje të mëtejshme prej 0.6 pikë përqindjeje krahasuar me muajin maj. Kryesisht, operacionet monetare janë përqëndruar në tërheqjen e likuiditetit të tepërt të sistemit me anë të repove njëjavore dhe përdorimit të depozitës njëditore. Niveli i likuiditetit të tepërt në sistem është luhatur midis nivelit 7.0 miliardë lekë në fillim të muajit qershor dhe minimumit prej 0.8 miliardë lekësh, në fund të këtij muaji. Në kushtet e nevojës së përkohshme të sistemit për likuiditet, Banka e Shqipërisë ka injektuar likuiditet nëpërmjet përdorimit të repove të anasjellta.

Qëndrueshmëria e kursit të këmbimit gjatë muajve të kaluar nuk ka bërë të nevojshme ndërhyrjen e Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm valutë. Treguesi i Mjeteve të Brendshme Neto (MBN) të Bankës së Shqipërisë shënoi një shmangie prej 3.6 miliardë lekësh nga objektivi i vendosur në programin monetar për muajin qershor. Shkak për shkeljen e objektivit të MBN ka qenë rritja jashtë parashikimit e parasë jashtë bankave në muajin qershor, rritje e cila është përballuar me injektimin e likuiditetit nëpërmjet tregut të parasë. Ky injektim është kryer nëpërmjet përdorimit të likuiditetit të tepërt të bankave tregtare të vendosur në repo pranë Bankës së Shqipërisë, çka është shoqëruar me rritjen përkatëse të MBN të Bankës së Shqipërisë. Rritja e kërkesës për para cash në muajin qershor ka tejkaluar parashikimet e bëra, duke reflektuar ndikimin e disa faktorëve, të cilët nuk ishin marrë parasysh në vendosjen e objektivit të MBN si; shpërndarja e fondeve të kreditorët e skemave piramidale dhe përqendrimi i rritjes së kërkesës së qeverisë dhe kredisë në lekë, në muajin qershor.

Tabelë 4. Realizimi i objektivave sasiorë të Bankës së Shqipërisë.


	Dhjetor '04	Janar '05	Shkurt'05	Mars '05	Prill '05	Maj '05	Qershor '05
Realizimi i objektivit të Rezervës Ndërkombëtare Neto (milionë dollarë)							
Objektivi	942	985	1,029	1,073	1,077	1,082	1,087
Aktuale	1,105	1,108	1,109	1,107	1,109	1,104	1,098
Diferenca	163	123	80	35	32	23	11
Realizimi i objektivit të Mjeteve të Brendshme Neto (miliardë lekë)							
Objektivi	79	73	67	61	61	60	60
Aktuale	61	56	56	53	56	57	64
Diferenca	-18	-16	-11	-8	-5	-3	4
Realizimi i objektivit të Kredisë Brendshme neto për qeverinë (miliardë lekë)							
Objektivi	286	288	289	292	294	296	298
Aktuale	285	286	288	288	290	291	294
Diferenca	-1	-2	-1	-4	-4	-5	-4

II.2 AGREGATËT MONETARË

Në përputhje me lehtësimin e kushteve monetare në ekonomi, treguesit e parasë kanë vijuar rritjen me ritme më të shpejta. Norma e rritjes vjetore të ofertës monetare ka shënuar një rritje relativisht të lartë në muajin qershor, duke arritur në 18.3 për qind, nga 15.8 për

qind që ishte në muajin maj. Kontributin kryesor në këtë ecuri e ka dhënë rritja vjetore e depozitave në valutë, e cila ka reflektuar rritjen e konsiderueshme të efektit vjetor të kursit të këmbimit¹¹. Gjithashtu, ritmi i rritjes së ofertës monetare në lekë, agregatiit M2, ka qenë në rritje, duke reflektuar rritjen e kërkesës për para të qeverisë dhe të ekonomisë në muajin qershor. Struktura kohore e ofertës monetare ka njohur rritjen e dukshme të peshës së mjeteve monetare likuide, si rezultat i rritjes së konsiderueshme të parasë jashtë bankave. Struktura sipas monedhave ka ruajtur tendencën e zhvendosjes drejt përbërësit të saj valutor, duke u pasqyruar në rritjen e raportit të depozitave në valutë ndaj ofertës monetare.


Grafik 9. Ecuria e normave vjetore të agregatëve monetarë.



Paraja jashtë bankave ka përbërë treguesin monetar me rritjen mujore më të shpejtë. Në muajin qershor, niveli i saj shënoi një rritje prej 5.1 miliardë lekësh ose 3.9 për qind. Norma e rritjes vjetore të parasë jashtë bankave u rrit ndjeshëm në 14.9 për qind, nga 11.6 për qind që ishte një muaj më parë. Përsheptimi i pazakontë i parasë jashtë bankave gjatë muajit qershor është favorizuar kryesisht nga faktorë me ndikim të përkohshëm si, rimbursimi i kreditorëve të firmave piramidale, përqëndrimi i kërkesës për para të qeverisë në periudhën e zgjedhjeve, dhe rritja e lartë e kredisë për ekonominë në lekë në muajin qershor. Të dhënat paraprake për muajt korrik dhe gusht tregojnë për shuarjen e efektit të disa prej faktorëve të mësipërm dhe rritjen e parasë jashtë bankave në përputhje me ecurinë sezonale të saj, të faktuar në vitet e kaluara.

Dalja e menjëhershme e parasë jashtë bankave është shoqëruar me rritjen e raportit të saj ndaj ofertës monetare. Në muajin qershor raporti i parasë jashtë bankave ndaj M3 arriti në 25.1 për qind, duke shënuar një rritje me 0.6 pikë përqindjeje nga muaji i kaluar.

Grafik 10. Raporti i PjB ndaj M3 dhe norma mesatare e interesit real të depozitave me afat në lekë (shkalla djathtas).



¹¹ Efekti i ndryshimit vjetor të kursit të këmbimit të lekut ndaj monedhave usd dhe euro (sipas peshave të tyre në depozitat në valutë) në muajin qershor është rritur në 1 për qind, nga -3.5 për qind që ishte në muajin maj.


Depozitat në lekë kanë kontribuar negativisht në rritjen e ofertës monetare në muajin qershor, duke shënuar një rënie prej 0.5 miliardë lekësh. Kjo ecuri ka ardhur si pasojë e rënies së depozitave pa afat në lekë me 1.5 miliardë lekë, ndërsa depozitat me afat në lekë janë rritur me 1 miliard lekë. Norma e rritjes vjetore të depozitave në lekë ka rezultuar në të njëjtin nivel me një muaj më parë, rreth 14.7 për qind, duke reflektuar kontributin në rritje të depozitave me afat të individëve. Ulja e normave të interesit në lekë dhe ngushtimi i diferencës së tyre me interesat në valutë ende nuk duket të kenë ndikuar negativisht në preferencën për depozitat në lekë.

Kontributi i depozitave pa afat në rritjen vjetore të depozitave totale në lekë megjithëse i lartë, ka pësuar rënie në muajin qershor, i ndikuar kryesisht nga rënia e depozitave të ndërmarrjeve publike¹². Ngadalësimi i ritmit të depozitave pa afat në lekë ka zbutur disi efektin e rritjes së parasë jashtë bankave në rritjen vjetore të agregatit M1. Norma vjetore e këtij treguesi në muajin qershor u rrit në 25.8 për qind, nga 24.0 për qind që ishte në muajin maj.

Depozitat në valutë kanë vazhduar trendin rritës të tyre edhe gjatë muajit qershor, duke shënuar një rritje prej 4 miliardë lekësh. Rritja e tyre është ndikuar pozitivisht nga nënçmimi mujor i kursit të këmbimit, i cili vlerësohet rreth 1.7 miliardë lekë. Nën ndikimin e rritjes së efektit vjetor të kursit të këmbimit, norma e rritjes vjetore të depozitave në valutë ka shënuar një rritje të ndjeshme, nga 23.3 për qind në muajin maj, në 30.2 për qind në muajin qershor. Në mungesë të efektit të kursit rritja vjetore e depozitave në valutë në terma realë do të ishte përkatësisht 27.6 për qind dhe 29 për qind.

Struktura e depozitave në valutë sipas afateve ka njohur një rritje të kontributit të depozitave pa afat, 2.7 miliardë lekë, kundrejt rritjes me 1.3 miliardë lekë të depozitave me afat. Kjo rritje i dedikohet në një masë të madhe rritjes së konsiderueshme të depozitave pa afat në valutë të sektorit privat, të cila kanë përbërë rreth 84 për qind të rritjes mujore të depozitave pa afat në valutë¹³.

Grafik 11. Ecuria e raportit të depozitave në valutë ndaj M3.



Ritmi relativisht më i shpejtë i rritjes së përbërësit valutor të ofertës monetare krahasuar me përbërësin e saj në lekë, është shoqëruar me rritjen e peshës së depozitave në valutë ndaj M3. Në përputhje me trendin e shfaqur që prej fillimit të vitit, muaji qershor ka shënuar rritjen e mëtejshme të këtij raporti në nivelin 25.1 për qind, nga 24.8 për qind që ishte në muajin maj.

¹² Shpërndarja e fondeve të firmave piramidale ka shkaktuar zvogëlimin e depozitave të sektorit shtetëror me rreth 1.5 miliardë lekë deri në muajin qershor.

¹³ Një rritje e tillë është ndikuar nga rritja me 2.1 miliardë lekë e depozitave pa afat të firmave private në Bankën Alfa.

Tabelë 5. Ecuria e treguesve monetarë në muajin qershor (në miliardë lekë).


	Qershor	Ndryshimi mujor		Ndryshimi vjetor	
	2005	Absolut	Përqindje	Absolut	Përqindje
Paraja jashtë bankave	135.8	5.1	3.9	17.6	14.9
Depozita totale	406.0	3.5	0.9	66.1	19.4
- në lekë	270.0	-0.5	-0.2	34.5	14.7
- në valutë	136.0	4.0	3.0	31.6	30.2
Depozita pa afat	90.5	1.2	1.4	25.5	39.3
- në lekë	41.0	-1.5	-3.6	18.7	83.7
- në valutë	49.5	2.7	5.8	6.9	16.1
Depozita me afat	315.5	2.3	0.7	40.6	14.7
- në lekë	229.0	1.0	0.4	15.9	7.4
- në valutë	86.5	1.3	1.5	24.7	39.9
M1	176.8	3.6	2.1	36.3	25.8
M2	405.8	4.6	1.1	52.1	14.7
M3	541.8	8.6	1.6	83.7	18.3
Baza monetare	180.4	5.9	3.4	23.4	14.9

II.3 KËRKESA E EKONOMISË PËR PARA

II.3.1 Mjetet valutore neto


Sistemi bankar në muajin qershor shënoi një ulje të mëtejshme në nivelin e mjeteve valutore neto. Nënçmimi i euros kundrejt dollarit amerikan prej 2 për qind krahasuar me një muaj më parë, duket se ka qenë faktori kryesor i uljes së mjeteve valutore neto të sistemit bankar. Këto mjete janë ulur me 29 milionë usd, ndërsa të llogaritura me kurs fiks kjo ulje është vetëm 6.7 milionë usd. Gjithësesi, kontributi i mjeteve valutore neto në rritjen vjetore të ofertës monetare gjatë muajit qershor ka shënuar një rritje të lehtë, duke arritur nivelin 34.2 për qind nga 26.3 për qind që ishte një muaj më parë.

Grafik 12. Kontributi vjetor i rritjes së MVN në rritjen e M3.



Nënçmimi i euros ndaj dollarit ka ndikuar më së shumti mjetet valutore neto të Bankës së Shqipërisë. Krahasuar me një muaj më parë këto mjete kanë shënuar një rënie prej 17.7 milionë usd. E llogaritur me kurs fiks kjo ulje është vetëm 2.7 milionë usd. Edhe në muajin qershor është vënë re rritje e kreditimit në valutë më e lartë se rritja e depozitave në valutë. Kjo e shoqëruar edhe me nënçmimin e euros kundrejt dollarit, ka ndikuar në uljen e mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë në masën 11.3 milionë usd.

Grafik 13. Ecuria e mjeteve valutore neto të sistemit bankar (në milionë dollarë).



II.3.2 Krediti i brendshëm


Kontributi i kreditit të brendshëm në kërkesën për para ka mbetur në nivelet e një muaji më parë, rreth 70 për qind. Gjithësesi për muajin qershor krediti i brendshëm ka pasqyruar një rritje vjetore prej 18.9 për qind ose rreth 3 pikë përqindje më e lartë se sa muaji maj. Kjo rritje është kanalizuar kryesisht në kreditimin për ekonominë, rritja e së cilës ka kontribuar me 65 për qind në rritjen vjetore të kreditit të brendshëm.

II.3.3 Kërkesa e qeverisë për para

Llogaritë fiskale të qeverisë deri në muajin qershor shënojnë një deficit buxhetor prej 6.8 miliardë lekësh me një rritje mujore prej 2.1 miliardë lekë. Financimi i këtij deficiti është përballuar nga burime të brendshme me 10.5 miliardë lekë, ndërsa depozita e qeverisë në Bankën e Shqipërisë ishte 3.7 miliardë lekë.

Pjesën kryesore të financimit të brendshëm e ka zënë emetimi i obligacioneve qeveritare dyvjeçare. Në muajin qershor, niveli i emtuar i këtyre obligacioneve u rrit me 1.5 miliardë lekë, duke arritur 8.8 miliardë lekë në total. Gjithashtu, kërkesa e qeverisë këtë muaj është plotësuar dhe nga blerja e bonove të thesarit. Bankat e nivelit të dytë kanë rritur portofolin e bonove të thesarit me 0.68 miliardë lekë. Individët kanë marrë pjesë në blerjen e bonove të thesarit duke rritur portofolin e tyre me 0.34 miliardë lekë. Një rritje e lehtë është vënë re dhe në portofolet e bonove të thesarit të institucioneve dhe të Bankës së Shqipërisë.

Grafik 14. Ecuria kumulative e financimit të deficitit buxhetor (në miliardë lekë).



II.3.4 Kredia për ekonominë nga sistemi bankar

Kredia për ekonominë në muajin qershor arriti në 95.9 miliardë lekë, duke u rritur brenda muajit me 7.1 miliardë lekë ose rreth 2 herë më shumë se sa rritja mujore e muajit maj. Krahasuar me një vit më parë kredia për ekonominë është rreth 70 për qind më e lartë. Në muajin qershor kredia në lekë u rrit me 3.3 miliardë lek ose 18 për qind më e lartë se sa kredia në lek e muajit maj. Kjo rritje përbënte 46 për qind të rritjes mujore të kredisë në total¹⁴, duke dëshmuar për një angazhim më të madh të bankave për kredinë në lekë¹⁵. Krahasuar me një vit më parë kredia në lekë është rreth 2.3 herë më e lartë. Kredia në valutë i është përmbajtur rritjeve të saj normale, me rritje vjetore 56 për qind dhe rritje mujore 6 për qind për muajin qershor.

Struktura kohore e kredisë së ekonomisë ka ndryshuar disi në favor të kredisë aftashkurtër, duke shënuar një ndarje pothuajse të barabartë të kredisë sipas afateve të shlyerjes.

Kredia për individët vazhdon të ruajë ritme të larta rritjeje edhe gjatë muajit qershor, duke përbërë rreth një të tretën e kredisë për ekonominë. Krahasuar me një vit më parë, kredia për individët është rritur me 76 për qind. Gjithsesi, kontributi mujor i këtij grupi ndaj rritjes të kredisë në total pasqyroi rënie, e cila mendohet se ka ardhur si pasojë e angazhimit të përkohshëm më të lartë të bankave në sektorin privat.

Tabelë 6. Tregues të tepricës së kredisë ndaj totalit (në përqindje).

	2003	T-1'04	T-2'04	T-3'04	T-4'04	T-1 05	Prill '05	Maj '05	Qersh '05
Teprica e kredisë (në mld lekë)	50.7	53.4	56.8	61.0	69.3	79.0	83.3	87.9	96.0
Kredi afatshkurtër	46.0	41.6	35.4	33.9	34.0	34.1	34.6	32.2	33.7
Kredi afatmesme	33.3	35.4	37.8	37.2	36.0	34.5	34.5	34.5	33.1
Kredi afatgjatë	20.7	23.0	26.8	28.9	30.0	31.4	30.8	33.2	33.1
Kredi për individët	24.5	26.0	29.3	30.8	30.6	31.0	30.9	31.1	30.8
Kredi për sektorin privat	75.5	74.0	70.7	69.2	69.4	69.0	69.1	68.9	69.2
Lekë	19.6	17	17	17	19.5	20.1	20.8	21.0	22.9
Valutë	80.4	83	83	83	80.5	79.9	79.2	79.0	77.1

Shpërndarja sektoriale e kredisë për muajin qershor, në përgjithësi ka mbetur e njëjtë me atë të muajit maj. Sektori i tregtisë vazhdon të përbëjë sektorin kryesor, që tërheq pjesën më të madhe të kredisë edhe pse gjatë vitit 2005 ka shfaqur tendenca rënëse, duke përbërë, në fund të muajit, rreth 19.5 për qind të portofolit të kredisë. Ndërkohë, që edhe këtë muaj, një rritje të lehtë ka shfaqur kredia për sektorin e ndërtimit, e cila përbën rreth 11.5 për qind të totalit të kredisë për ekonominë.

Gjatë muajit qershor është akorduar 12.7 miliardë lekë kredi e re ose 1.3 herë më shumë se sa një muaj më parë. Ky nivel përbën nivelin më të lartë të kredisë së re të akorduar brenda një muaji gjatë gjithë periudhës prej më shumë se një vit, ku aktiviteti kreditues po njih rritje të përshpejtuar. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar vihet re se kredia e re e akorduar po zhvendoset drejt afateve të gjata të maturimit si dhe po preferohet kredia në lekë.

¹⁴ Në muajin maj kontributi mujor i kredisë në lekë ndaj totalit ishte rreth 33 për qind.

¹⁵ Gjatë muajit qershor Banka Kombëtare Greke i ka akorduar 1.2 miliardë lekë kredi një mujore në lekë, një kompanie private. Kjo kredi është shlyer gjatë muajit korrik.

Tabelë 7. Tregues të kredisë së re ndaj totalit (në përqindje).


	2004		2005			
	Qershor	Dhjetor	Mars	Prill	Maj	Qershor
Kredia e re (në mld lekë)	7.6	11.0	8.5	10.4	9.5	12.6
Kredi afatshkurtër	61.1	56.4	51.3	50.3	39.8	49.9
Kredi afatmesme	26.0	23.4	24.3	28.0	37.8	28.3
Kredi afatgjatë	12.9	20.2	24.4	21.7	22.4	21.8
Lekë	33.8	26.7	28.7	26.2	33.4	37.9
Valutë	66.3	73.3	71.3	73.8	66.6	62.1

II.4 TREGJET DHE ECURIA E NORMAVE TË INTERESIT

II.4.1 Ecuria e likuiditetit

Muaji korrik ka shënuar rënie të ndjeshme të nivelit të likuiditetit në sistemin bankar, krahasuar me një muaj më parë. Niveli mesatar ditor i likuiditetit zbriti në vlerën 3.0 miliardë lekë nga 6.0 miliardë lekë në muajin qershor dhe 8.9 miliardë lekë një vit më parë.

Grafik 15. Niveli ditor i likuiditetit në sistemin bankar (në miliardë lekë).




Gjatë pjesës së parë të muajit korrik, likuiditeti i tepërt është tërhequr rregullisht me anë të ankandeve repo njëjavore me çmim fiks. Investimi mesatar në repo është ulur me 2.9 miliardë lekë krahasuar me muajin qershor, duke rezultuar në vlerën 2.0 miliardë lekë. Në fund të muajit korrik, përmbushja e kërkesës për rezervën e detyruar bëri që sistemi bankar të rezultonte me nevoja për likuiditet, i cili u injektua me anë të ankandit të anasjelltë të repos njëjavore. Ky instrument u përdor për herë të parë gjatë këtij viti, për shumën mesatare 0.45 miliardë lekë.

Lehtësia e depozitës njëditore është përdorur gjerësisht nga bankat, veçanërisht në pjesën e dytë të muajit. Mesatarisht, niveli i depozitës njëditore në muajin korrik shënoi vlerën 1.1 miliardë lekë ose 0.5 miliardë lekë më shumë se një muaj më parë. Kredia njëditore është përdorur rrallë dhe nevojat për likuiditet janë plotësuar në tregun ndërbankar.

Vëllimi i huadhënies në tregun ndërbankar ka regjistruar një rënie prej 0.42 miliardë lekësh krahasuar me muajin qershor. Niveli mesatar ditor i huadhënies në muajin korrik rezultoi

1.16 miliardë lekë, nga të cilat 41 për qind e zë huadhënia me maturim njëjavor. Në muajin qershor, huadhënia njëjavore zinte 53 për qind të totalit në tregun ndërbankar.

Grafik 16. Vëllimi i huadhënies në tregun ndërbankar (në miliardë lekë).




Në muajin korrik, u vu re një moment i pakësimit të pjesëmarrjes së sistemit bankar në tregun primar, gjë që çoi dhe në rritjen e *yield*-eve të bonove të thesarit. Oferta për investim në bono thesari nuk arriti të plotësonte gjithmonë kërkesën e qeverisë. Portofoli i bankave në bono thesari llogaritet 4.3 miliardë lekë më i ulët se në muajin qershor, ndërsa ai me obligacione dyvjeçare është rritur me 1.7 miliardë lekë.

II.4.2 Ecuria e normave të interesit

Gjatë muajit qershor, normat e interesit në tregun e depozitave në lekë¹⁶ kanë vijuar të ulen, duke ngushtuar gjithnjë e më tepër diferencën me normat e interesit të depozitave në valutë.

Grafik 17. Spread-i midis interesave mesatarë të ponderuar të depozitave (me afat nën një vit) në lekë me ato në valutë.




Në muajin qershor, interesat realë të depozitave 12-mujore në lekë ranë në nivelin 0.96 për qind, nga 2.86 për qind një muaj më parë dhe nga 3.56 për qind një vit më parë. Këtu ka ndikuar ulja e interesave nominale të depozitave 12-mujore në lekë dhe rritja e lehtë e inflacionit në muajin qershor.

Në muajin korrik është vënë re rritje e interesave në tregun ndërbankar, në tregun primar dhe në tregun e obligacioneve 2-vjeçare të qeverisë.

¹⁶ Ulja e interesave të depozitave në lekë ishte në të gjitha afatet.

Grafik 18. Ecuria e normave të interesit



*interesat e depozitave tremujore në lekë për muajin korrik, janë sipas të dhënave operative.

Kjo sjellje e normave të interesit është ndikuar nga nga pakësimi i likuiditeteve të tepërta të bankave tregtare pranë Bankës së Shqipërisë, nga ndryshimi i raporteve kërkesë ofertë në treg ndërbankar, nga ngushtimi i korridorit të poshtëm të interesave të lehtësive mbështetëse¹⁷, nga rritja e kërkesës për likuiditete në periudhën e plotësimit të rezervës së detyruar, etj.

Tabelë 8. Tregjet që kanë shfaqur tendenca të rritjes së normave të interesit në lekë.


në %)	qershor 05	korrik 05	ndryshimi int. korrik-qershor
yield-i i bonove të thesarit 3 - mujore	5.03	5.16	+0.13
yield-i i bonove të thesarit 6 - mujore	6.42	6.58	+0.16
yield-i i bonove të thesarit 12 - mujore	6.81	6.97	+0.16
Interesat e tregut ndërbankar 1 - ditor	2.50	4.50	+2.00
yield-i i obligacioneve qeveritare 2 - vjeçare	7.55	7.70	+0.15

*të dhënat e muajit korrik janë operative

Në tregun e kredive në lekë, interesat mesatarë të ponderuar të kredive (në total) në muajin qershor, janë ulur në nivelin 12.6 për qind nga 13.4 për qind, që ishin një muaj më parë.

¹⁷ Në datën 13 korrik 2005, Banka e Shqipërisë mori vendim për ngushtimin e korridorit të lehtësive mbështetëse, në nivelin ± 1.75 për qind, ndaj normës bazë të interesit (sistemi kaloi në korridor simetrik).

Grafik 19. Normalt mesatare të ponderuara të interesit të kredive në lekë (në total).



Ndryshe nga tendenca e mëparshme, në muajin qershor interesat e depozitave në usd, janë ulur në të gjitha afatet. Në këtë periudhë mendohet se kanë ndikuar më shumë faktorët e brendshëm sezonalë, si rritja e prurjeve të valutës, nënçmimi i dollarit në tregun e brendshëm valutor, sesa ecuria e tregjeve ndërkombëtare. Norma mesatare e ponderuar e depozitave me afat në dollarë zbriti në nivelin 1.91 për qind ose 0.08 pikë përqindjeje më poshtë se një muaj më parë .

Interesat e depozitave në euro kanë mbetur pothuajse të pandryshuara në muajin qershor. Norma mesatare e ponderuar e depozitave në euro rezultoi në nivelin 1.73 për qind, duke qenë e njëjtë me atë të muajit maj.


Në fund të muajit qershor norma mesatare e ponderuar e interesit për kredinë në dollarë ishte 8.1 për qind ndërsa për euron 5.6 për qind duke paraqitur rënie krahasuar më një muaj më parë sikurse dhe interesat e kredive në lekë.

II.4.3 Kursi i këmbimit

Gjatë muajve të verës leku ka patur një prirje të qartë mbiçmimi kundrejt euros ndërsa ka patur si fillim nënçmim ndaj dollarit dhe së fundmi mbiçmim ndaj tij. Në muajin qershor u vu re kulmimi i mbiçmimit të dollarit kundrejt lekut, i ndikuar nga ecuria e dollarit amerikan kundrejt euros në tregjet ndërkombëtare. Nga ana tjetër edhe pse gjatë muajit qershor ka patur flukse hyrëse të valutës së huaj nga sezoni turistik, kryesisht euro, përsëri mbiçmimi i lekut kundrejt euros ka hasur rezistencë. Në terma mujorë, leku është nënçmuar me 2.7 për qind ndaj dollarit amerikan ndërkohë që nuk ka paraqitur luhatje ndaj euros.

Gjatë muajit korrik, dollari amerikan ka humbur pikë në tregun ndërkombëtar gjë që në tregun tonë valutor është pasqyruar si një mbiçmim i lekut me 2.3 për qind krahasuar me muajin qershor. Euro gjatë këtij muaji ka humbur rezistencën dhe është nënçmuar me rreth 2.3 për qind kundrejt lekut. Në terma efektivë nominalë leku është mbiçmuar me 2 për qind gjatë muajit korrik. Nivelet e këmbimit të lekut në fund të muajit korrik janë 121.3 lek/euro dhe 100.4 lek/usd, kundrejt niveleve përkatësisht 126.4 lek/euro dhe 92.6 lek/usd në fillim të këtij viti.

Grafik 20. Ecuria e kursit të këmbimit të lekut





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

V E N D I M

Nr. 71, datë 31.08.2005

**PËR MIRATIMIN E UDHËZIMIT
“MBI MËNYRËN E LLOGARITJES SË “FIKSIT” TË KURSIT TË KËMBIMIT
TË LEKUT, NË BANKËN E SHQIPËRISË”**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozim të Departamentit të Operacioneve Monetare, në mbështetje të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Të miratojë udhëzimin “Mbi mënyrën e llogaritjes së “Fiksit” të kursit të këmbimit të lekut, në Bankën e Shqipërisë”, sipas teksit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun, me publikimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi me botimin e tij në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, udhëzimi “Mbi mënyrën e llogaritjes së “fiksit” të kursit të këmbimit të lekut, në Bankën e Shqipërisë” miratuar me vendimin numër 36, datë 30.04.2003, shfuqizohet.

SEKRETARI

Ylli Memisha

KRYETARI

Ardian Fullani

BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

UDHËZIMI
“MBI MËNYRËN E LLOGARITJES SË “FIKSIT”
TË KURSIT TË KËMBIMIT TË LEKUT, NË BANKËN E SHQIPËRISË”

Neni 1
BAZA LIGJORE DHE RREGULLATIVE

Ky udhëzim mbështetet në nenet 59 dhe 60 të ligjin nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” dhe në rregulloren e Departamentit të Operacioneve Monetare të Bankës së Shqipërisë.

Neni 2
QËLLIMI

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i mënyrës së llogaritjes së “fiksit” për efekte të përftimit të një niveli të vetëm reference të kursit të këmbimit të lekut, i cili më pas mund të përdoret nga të interesuarit për qëllime statistikore, krahasuese, kontabilizuese, vlerësuese dhe tregtuese.

Neni 3
PËRKUFIZIME

3.1 Fiksi është kursi zyrtar i këmbimit i disa prej monedhave të huaja kundrejt lekut, që përfaqësohet nga një vlerë e vetme dhe publikohet nga Banka e Shqipërisë.

3.2 Pjesëmarrësit janë bankat e nivelit të dytë dhe zyrat e këmbimit valutor, të cilat ofrojnë kurset e këmbimit të blerjes dhe të shitjes së euros dhe dollarit amerikan kundrejt lekut, në bazë të të cilave llogaritet fiksi i euros dhe dollarit amerikan kundrejt lekut.

3.3 Monedha e referencës është ajo monedhë, kursi fiks i së cilës llogaritet drejtëpërdrejtë nga kuotimet e pjesëmarrësve në procesin e fiksit. Njëkohësisht, kursi fiks i kësaj monedhe shërben për llogaritjen e kursit fiks të këmbimit për monedha të tjera të përfshira në fiks.

Neni 4

PJESËMARRËSIT NË PROCES

Pjesëmarrës në procesin e “fiksit” janë jo më pak se 6 banka të nivelit të dytë, që operojnë brenda vendit dhe vëllimi i veprimeve të cilave përbën jo më pak se 60 për qind të vëllimit total të tregut ndërbankar. Pjesëmarrëse janë dhe 4 zyra të këmbimit valutor, që operojnë në qytetin e Tiranës, sipas zgjedhjes së bërë nga Departamenti i Operacioneve Monetare, mbi bazën e vëllimit të tregtimit dhe të rregullsisë së raportimit të veprimeve të këmbimit valutor. Pjesëmarrja në procesin e “fiksit”, nuk i jep pjesëmarrësve favore. Detyrimet në këtë rast, lidhen me korrektesën në dërgimin në Bankën e Shqipërisë të të dhënave që kërkohen, në kohën dhe në mënyrën e përcaktuar më poshtë. Banka e Shqipërisë rishikon listën e pjesëmarrësve të zgjedhur, të paktën një herë në vit.

Neni 5

KOMUNIKIMI

5.1 Bankat e nivelit të dytë i komunikojnë kurset e këmbimit të dollarit amerikan dhe euros nëpërmjet faqeve të tyre në Reuters. Nëse për arsye teknike një gjë e tillë është e pamundur, bankat duhet t’i japin kurset e tyre nëpërmjet Reuters Dealing, faksit ose postës elektronike.

5.2 Bankat, pasi njoftohen me shkrim nga Departamenti i Operacioneve Monetare se do të jenë pjesëmarrëse në procesin e llogaritjes së fiksit, janë të detyruara që në intervalin e kohës të përcaktuar për llogaritjen e “fiksit”, të hedhin në faqet e tyre në Reuters të dhënat më të fundit të kursit të këmbimit të lekut kundrejt valutave kryesore.

Neni 6

KOHA E LLOGARITJES SË KURSIT TË KËMBIMIT “FIKSIT”

Llogaritja e kursit të këmbimit “fiks”, bëhet çdo ditë pune nga specialisti i këmbimeve valutore pranë Departamentit të Operacioneve Monetare. Procedura e llogaritjes fillon në orën 11.30.

Neni 7

MARRJA E INFORMACIONIT

7.1 Duke filluar nga ora 11.30, specialisti i këmbimeve valutore sigurohet që bankat e nivelit të dytë të paraqesin në faqen e tyre në Reuters kursin më të fundit¹ të këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan dhe euros, me të cilin ato

¹ Për këtë, specialisti i këmbimeve valutore identifikon datën e vlefshmërisë së kurseve të këmbimit.

janë të gatshme të tregtojnë në tregun ndërbankar. Kursi i këmbimit, si më sipër, duhet të përmbajë dy vlera, të blerjes dhe të shitjes.

7.2 Nëse vëren mosrespektim të kërkesave të këtij udhëzimi për komunikimin e të dhënave, specialisti i këmbimeve valutore kontakton me subjektin pjesëmarrës (ose subjektet) për marrjen e të dhënave (iu kërkon hedhjen e të dhënave në faqen përkatëse ose dërgimin e tyre nëpërmjet Reuters dealing, e-mail ose faksit). Rastet e mosrespektimit të kërkesave të udhëzimit lidhur me komunikimin evidentohen çdo ditë dhe kur ato janë të përsëritura për një subjekt të caktuar, specialisti i këmbimeve valutore njofton drejtuesit² e Departamentit të Operacioneve Monetare dhe të Departamentit të Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë. Njëkohësisht, specialisti i këmbimeve valutore sheh mundësinë e përjashtimit të këtij subjekti nga lista e pjesëmarrësve të zgjedhur dhe zëvendësimit të tij me një subjekt tjetër.

7.3 Duke filluar nga ora 11.30, specialisti i këmbimeve valutore kontakton me zyrat e këmbimit valutor dhe merr prej tyre kursin e këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan dhe euros që ato deklarojnë se kanë të publikuara në tabelat e tyre.

Neni 8

PËRPUNIMI I INFORMACIONIT

8.1 Dollari amerikan është valuta e referencës. Në bazë të raporteve të valutave të tjera, me përjashtim të njësisë monetare të Bashkimit Monetar Evropian (euro), me valutën e referencës në tregun ndërkombëtar, llogaritet kursi i këmbimit të lekut kundrejt tyre.

8.2 Me marrjen e informacionit, specialisti i këmbimeve valutore i hedh të dhënat në progamin përkatës, i cili i rendit kurset sipas rendit zbritës duke nisur nga vlera më e lartë. Pasi përjashton dy vlerat më të ulëta dhe të larta të këmbimit të dollarit amerikan dhe euros kundrejt lekut, llogarit vlerën mesatare të kuotimeve të mbetura për të dyja këto monedha. Vlerat që përftohen përfaqësojnë “fiksion” e kursit të këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan dhe euros.

8.3 Me përfitim të vlerës së “fiksionit” të kursit të këmbimit të lekut kundrejt valutës së referencës si më sipër, llogariten raportet e këmbimit të lekut kundrejt valutave të tjera, sipas raporteve të tyre në tregun ndërkombëtar kundrejt dollarit amerikan në momentin e llogaritjes së “fiksionit”.

8.4 Çdo ditë, do të llogaritet “fiksion” për këto valuta: dollarin amerikan, euron, jenin japonez, paundin britanik, frangën zvicerane, dollarin australian, dollarin kanadez, koronën suedeze, koronën norvegjeze, koronën daneze dhe njësinë

² Drejtorin dhe zëvendësdrejtorin.

monetare të Fondit Monetar Ndërkombëtar. Çdo ditë, do të llogaritet “fiksi” për këto metale të çmuara : ar (për 1 onc) dhe argjend (për 1 onc).

8.5 Dy herë në muaj, në ditën e mesit dhe të fundit të punës të çdo muaji, do të llogaritet “fiksi” për këto monedha: lira turke, leva bullgare, juani kinez, tolari sloven, fiorinta hungareze, rubla ruse, kuna kroate, korona çeke dhe dinari maqedonas. Për llogaritjen e kursit zyrtar të këmbimit të të gjitha monedhave të përmendura në këtë paragraf, si valutë reference përdoret kursi i dollarit amerikan me lekun.

8.6 Nëse gjykohet e nevojshme si rezultat i zhvillimeve në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore, valutat për të cilat llogaritet “fiksi” me frekuencë ditore ose më të rrallë, mund të shtohen ose të pakësohen. Propozimi për shtimin ose pakësimin e monedhave bëhet nga Departamenti i Operacioneve Monetare dhe miratohet nga Administratori Përgjegjës.

Neni 9

PUBLIKIMI DHE SHPALLJA E “FIKSIT”

9.1 Me përfundimin e procesit të llogaritjes së kursit zyrtar të këmbimit, rreth orës 12.00, specialisti i këmbimeve hedh të dhënat e “fiksit” të ri të llogaritur, në faqen e Bankës së Shqipërisë në Reuters, në faqen e Bankës së Shqipërisë në internet dhe në sistemin automatik që përdoret në Bankën e Shqipërisë. Nëse për arsye teknike, një gjë e tillë është e pamundur, informacioni jepet nëpërmjet telefonit, faksit ose postës elektronike. Njëkohësisht, specialisti i këmbimeve valutore i dërgon të dhënat pranë departamenteve të Bankës së Shqipërisë, që janë të interesuara.

9.2 Çdo person fizik ose juridik, mund ta përfitojë “fiksin” e kursit të këmbimit. Për këtë duhet që subjekti i interesuar të bëjë një kërkesë me shkrim (shkresë, faks ose e-mail³) drejtuar Bankës së Shqipërisë. Nëse informacioni kërkohet për kurse ditore të monedhave të huaja kundrejt lekut, kërkesa duhet dërguar në vëmendje të Departamentit të Operacioneve Monetare. Përgjigja për çdo kërkesë për informacion nëpërmjet shkresës, nënshkruhet nga një prej drejtuesve të Departamentit të Operacioneve Monetare dhe vuloset. Nëse informacioni kërkohet për tregues të përpunuar të “fiksit” (për shembull, mesatare mujore, tremujore etj.), kërkesa dërgohet pranë Departamentit të Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës.

³ Adresa : public@bankofalbania.org

Neni 10
RUAJTJA DHE ARKIVIMI

Specialisti i këmbimeve valutore në Departamentin e Operacioneve Monetare, përveç formës elektronike, i ruan të dhënat për çdo proces të “fiksit” (faqet dhe bisedat në Reuters, mesazhet në e-mail etj.) edhe në formë fizike. Në përputhje me rregullat e Bankës së Shqipërisë për arkivimin e materialeve, kryen dërgimin e tyre periodik në arkivë. Në çdo rast, specialisti i këmbimeve valutore siguron që çdo fletë e llogaritjes së “fiksit” të nënshkruhet prej tij dhe nga një prej drejtuesve të departamentit.

Neni 11
HYRJA NË FUQI

Ky udhëzim u miratua me vendimin numër 71, datë 31.08.2005 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe hyn në fuqi me botimin e tij në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës

Ardian FULLANI

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 1, Shkurt 2005

1. Vendim nr.01, datë 26.01.2005 “Për miratimin e deklaratës së Bankës së Shqipërisë mbi zhvillimet ekonomike dhe monetare për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2004”.
2. Vendim nr.02, datë 26.01.2005 “Për miratimin e deklaratës së Bankës së Shqipërisë mbi stabilitetin e sistemit financiar në Shqipëri”.
3. Vendim nr.03, datë 26.01.2005 “Për një ndryshim në rregulloren “Për dhënien e licencës, për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë””.
4. Vendim nr.04, datë 26.01.2005 “Për caktimin e afateve të plotësimit të kërkesës për rritjen e kapitalit të kërkuar të bankave”.
5. Vendim nr.08, datë 26.01.2005 “Për lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Marrëdhënieve me Publikun në Bankën e Shqipërisë”.
6. Vendim nr.09, datë 26.01.2005 “Për lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Logjistike të Bankës së Shqipërisë”.
7. Vendim nr.10, datë 26.01.2005 “Për emërimin e Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Logjistike të Bankës së Shqipërisë”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 2, Shkurt 2005

1. Vendim nr.11, datë 09.02.2005 “Për miratimin e dokumentit për misionin e mbikëqyrjes”.
2. Vendim nr.12, datë 09.02.2005 “Për dhënien e miratimit paraprak të licencës për të ushtruar veprimtari bankare, të bankës së propozuar “Union Bank” sh.a.”.
3. Vendim nr.13, datë 09.02.2005 “Për miratimin e kontratës - tip për marrëveshjet e riblerjeve dhe të anasjellta të riblerjeve të letrave me vlerë”.
4. Vendim nr.14, datë 09.02.2005 “Për miratimin e rregullores për dhënien e kredive për strehimin dhe përmirësimin e kushteve të banimit të punonjësve të Bankës së Shqipërisë”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 3, Shkurt 2005

1. Vendim nr.15, datë 23.02.2005 “Për miratimin e Raportit të Politikës Monetare për muajin janar të vitit 2005”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 4, Prill 2005

Vendim nr.18, datë 09.03.2005 “Për miratimin e konfigurimeve të vizatimeve të monedhave përkujtime, që do të shtypen për qëllime numizmatike, në vitin 2005”.

Vendim nr.19, datë 09.03.2005 “Për mënyrën e vlerësimit të vlerave numizmatike pa kosto në Bankën e Shqipërisë”.

Vendim nr.22, datë 09.03.2005 “Për lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës të Bankës së Shqipërisë”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 5, Prill 2005

1. Vendim nr.24, datë 30.03.2005 “Për uljen e përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes nga Banka e Shqipërisë”.
2. Vendim nr.27, datë 30.03.2005 “Për shtypjen e monedhave për qëllime numizmatike, për vitin 2006”.
3. Vendim nr.28, datë 30.03.2005 “Për miratimin e rregullores për mbikëqyrjen e transaksioneve bankare në rrugë elektronike”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 6, Maj 2005

1. Vendim nr. 30, datë 27.04.2005 “Për miratimin e raportit të politikës monetare për muajin mars të vitit 2005”.
2. Vendim nr. 31, datë 27.04.2005 “Për një ndryshim në rregulloren për normat e mbikëqyrjes së subjekteve jobanka që ushtrojnë veprimtari financiare”.
3. Vendim nr. 32, datë 27.04.2005 “Për miratimin e sistemit raportues për subjektet jobanka që ushtrojnë veprimtari financiare”.

4. Vendim nr. 33, datë 27.04.2005 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 25, datë 01.04.2003 për miratimin e strukturës organizative dhe numrin e punonjësve të Bankës së Shqipërisë për vitin 2003".
5. Vendim nr. 35, datë 27.04.2005 "Për miratimin e udhëzimit mbi procedurat dhe shpenzimet e daljes jashtë shtetit për shërbim, kualifikim etj., të punonjësve dhe të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 7, Maj 2005

1. Vendim nr. 36, datë 19.05.2005 "Për miratimin e udhëzimit mbi procedurat e shtypjes, rishtypjes dhe të emetimit të kartëmonedhave dhe monedhave metalike nga Banka e Shqipërisë".
2. Vendim nr. 38, datë 19.05.2005 "Për miratimin e rregullores mbi procedurat e ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore".
3. Vendim nr. 40, datë 19.05.2005 "Për lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Kontabilitetit dhe Pagesave në Bankën e Shqipërisë".
4. Vendim nr. 41, datë 19.05.2005 "Për emërimin e Drejtorit të Departamentit të Kontabilitetit dhe Pagesave të Bankës së Shqipërisë".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 8, Qershor 2005

1. Vendim nr. 42, datë 08.06.2005 "Për miratimin e opinionit të Bankës së Shqipërisë mbi gjendjen e ekonomisë gjatë tremujorit të parë të vitit 2005".
2. Vendim nr. 43, datë 08.06.2005 "Për miratimin e rregullores për mbikëqyrjen e shoqërive të kursim - kreditit dhe unioneve të tyre".
3. Vendim nr. 44, datë 08.06.2005 "Për miratimin e sistemit raportues për shoqëritë e kursim - kreditit dhe të unioneve të tyre".
4. Vendim nr. 45, datë 08.06.2005 "Për disa ndryshime në udhëzimin për kapitalin rregullator të Bankës së Shqipërisë".
5. Vendim nr. 46, datë 08.06.2005 "Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren për mjaftueshmërinë e kapitalit".
6. Vendim nr. 47, datë 13.06.2005 "Për miratimin e transferimit të pronësisë së aksioneve të kapitalit aksioner të Bankës Dardania sh.a. nga fondet për rindërtimin e Kosovës tek Fonds der Republik der Kosova, Gjermani".

7. Vendim nr. 48, datë 13.06.2005 "Për miratimin e transferimit të pronësisë së aksioneve të kapitalit aksioner të Bankës Dardania sh.a. nga Fonds der Republik der Kosova, Gjermani tek Francesco Mariano Mariano dhe Banca Popolare Pugliese (Banka Popullore Pulieze)".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 9, Qershor 2005

1. Vendim nr. 49, datë 29.06.2005 "Për miratimin e "Raportit të Politikës Monetare për muajin maj të vitit 2005"".
2. Vendim nr. 51, datë 29.06.2005 "Për miratimin e rregullores "Për procedurat e sistemit të kryqëzimit të pagesave me vlerë të vogël (AECH)"".
3. Vendim nr. 52, datë 29.06.2005 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për funksionimin e sistemit të kryqëzimit të pagesave me vlerë të vogël AECH"".
4. Vendim nr. 53, datë 29.06.2005 "Për "miratimin e tarifave të përdorimit të sistemit shqiptar të kryqëzimit të pagesave me vlerë të vogël AECH"".
5. Vendim nr. 54, datë 29.06.2005 "Për disa ndryshime në "Rregullat dhe procedurat e sistemit shqiptar të pagesave ndërbankare AIPS"".
6. Vendim nr. 55, datë 29.06.2005 "Për disa ndryshime në "Rregullat e brendshëm të funksionimit të sistemit shqiptar të pagesave ndërbankare AIPS.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 10, Korrik 2005

1. Vendim nr. 56, datë 13.07.2005 "Për miratimin e rregullores "Mbi transaksionet e shitbjeve me të drejta të plota"".
2. Vendim nr. 57, datë 13.07.2005 "Për miratimin e rregullores "Për kredinë Lombard"".
3. Vendim nr.58, datë 13.07.2005 "Për miratimin e rregullores "Për depozitën njëditore"".
4. Vendim nr. 59, datë 13.07.2005 "Për miratimin e rregullores "Për kredinë njëditore"".
5. Vendim nr. 60, datë 13.07.2005 "Për vendosje komisioni në sportelet e Bankës së Shqipërisë për bonot e thesarit".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 11, Gusht 2005

1. Vendim nr.66, datë 28.07.2005 “Për miratimin e deklaratës së Bankës së Shqipërisë “Mbi zhvillimet ekonomike dhe monetare për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2005”.
2. Vendim nr. 67, datë 28.07.2005 “Për miratimin e deklaratës së Bankës së Shqipërisë “Mbi stabilitetin e sistemit financiar në Shqipëri”.
3. Vendim nr.68, datë 28.07.2005 “Për miratimin e rregullores “Për mbikëqyrjen e konsoliduar”.